



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 27 datë 19/04/2018

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI
6% PËR PERIUdhËN 1-31 MARS 2018**

Në mbështetje të nenit 29 të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005, ndryshuar me ligjin nr.10399, datë 17.03.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355, datë 10.03.2005", Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore të VKM-se nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe të masës së ndihmës ekonomike" i ndryshuar, dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2018 në total **5 (pesë)** familje, me fond total prej **23760 (njëzetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë)** lekë. Konkretisht:

PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2018 **2 (dy)** familje, me një fond **10080 (dhjetë mijë e tetëdhjetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE STRUM

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2018 **1 (një)** familje me një fond **5760 (pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2018 **1 (një)** familje, me një fond **3060 (tre mijë e gjashtëdhjetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2018 **1 (një)** familje, me një fond **4860 (katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë)** lekë.



Bashkia Roskovec

Mars 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Ateshi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Lindita Vangjel Hoxha		4	Familje në nevojë	5220
2	Miranda Veis Kola		4	Familje në nevojë	4860
	Shuma				10080

Mbyllet me nr rendor 2 (dy)

KRYETAR KËSHILLI




Njësia Administrative Strum
Mars 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Felleza Ramadan Ruko		5	Familje në nevojë	5760
	Shuma				5760

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

KRYETAR KËSHILLI
Eleni Goga




Njësia Administrative Kuman
Mars 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Kujtim Nazif Azizaj		2	Familje në nevojë	3060
	Shuma				3060

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

KRYETAR KËSHILLI
Eleni Goga



Njësia Administrative Kurjan

Mars 2018

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Ateshi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Lindita Skënder Hyska		4	Familje në nevojë	4860
	Shuma				4860

Mbyllet me nr rendor 1 (një)

KRYETAR KËSHILLI

Eleni Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 28. DATE 19.04.2018

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.73 DATË 24.11.2017“PËR MIRATIMIN E
PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2018”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar dhe VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alterantiv të detyrimit të taksës”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- Një ndryshim në vendimin nr.73 datë 24.11.2017 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018”, në mbështetje të VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësimin alterantiv të detyrimit të taksës”,

Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

1. **0,05%**, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim për Njësine Administrative Roskovec dhe minus 10% të nivelit të shkallës së taksës për Njësiti Administrative Kuman, Strum dhe Kurjan.
2. **0,2%**, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;



3. Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim:

a) Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është **1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve**. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.

b) Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është **70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve**.

c) Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur është **30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve**.

ç) Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është **50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve**.

d) Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është **30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor**.

dh) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" i ndryshuar, çmimi për meter katror është **70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë**.

- 4. c) 30% e shkalles së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.**



- Një ndryshim në vendimin nr.73 datë 24.11.2017 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018” në mbështetje të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar me 1 Prill 2018.

Taksa e tabelës

Nr.	Llojet e Tabelave	Nj/matëse	Bashkia Roskovec (Kat. III)
I.	I.Taksë table për qëllim identifikimi, të trupëzuara ose jo, brënda territorit,ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të treta.		
a	Deri në 2 m2	Lekë/m2/vit	0
b	Mbi 2 m2 deri 10m2		
	e thjeshtë	Lekë/m2/vit	7 000
	me ndricim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	11 500
	elektronike	Lekë/m2/vit	15 000
c	Mbi 10m2 deri 20m2		
	e thjeshtë	Lekë/m2/vit	5 950
	me ndricim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	9 775
	elektronike	Lekë/m2/vit	12 750
ç	Mbi 20m2 deri 40m2		
	e thjeshtë	Lekë/m2/vit	3 850
	me ndricim të thjeshtë	Lekë/m2/vit	6 325
	elektronike	Lekë/m2/vit	8 250
d	Mbi 40m2		
	e thjeshtë	Lekë/m2/vit	2 800
	me ndricim të thjeshte	Lekë/m2/vit	4 600
	elektronike	Lekë/m2/vit	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabela identifikuese	Lekë/m2/vit	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme deri në tavanin maksimal 35m2		
	E thjeshtë(me/pa ndricim)	Lekë/m2/vit	13 500
	Elektronike	Lekë/m2/vit	27 000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.		
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë/m2/vit	1000



Shënim: Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri më 10m² do ti shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes se mbi 10m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh., nje table te thjeshte 15m², shuma e taksës vjetore do te llogaritet:

$$(10\text{m}^2 * 15000 \text{ leke}) + (5\text{m}^2 * 12750 \text{ leke}) = 150\ 000 + 63\ 750 = 213\ 750 \text{ leke/vit}$$

E njëjta llogjike llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetem njëra nga dy tabelat identifikuese do te konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

KRYETAR

Eleni Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 29, date 19/04/2018

"PER DHENIE NDIHME"

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH", te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore", Udhezimi nr.2 date 6.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar, 76 date 22.12.2017 "Per miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec per vitin 2018", si dhe materjaleve te sjella nga zyra e ndihmes ekonomike; Keshilli i Bashkise;

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit prej 200,000 leke per dhenie ndihme ekonomike per familjet e meposhtme per shkak se nuk kane shtepi banimit, problematikat qe kane keto familje (familje rome) per pamundesine e pageses se qerave, te energjise elektrike etj:

1. Sulejman Latifi 50,000 leke
2. Tajar Latifi 50,000 leke
3. Behar Latifi 50,000 leke
4. Jeta Hoxha 50,000 leke

Gr.00 Tit.01110 Kap.5 Art.606 - 200,000 leke

2. Ky fond te perballohet nga fondi I miratuar ne buxhetin e vitit 2018 "Per ndihma per jetimet+invalitet dhe familjet e varfera".

Gr.00 Tit.01110 Kap.5 Art.606 - 200,000 leke





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 30 datë 19/04/2018

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT MBI ZHVILLIMIN E BUJQËSISË NË
BASHKINË ROSKOVEC**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore " dhe në bazë të "Memorandumit të Mirëkuptimit" datë 23.01.2018 midis Bankers Petroleum Albania LTD dhe CBS Creative Business Solutions, Këshilli i Bashkisë ,

VENDOSI :


Miratimin e "Studimit mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Bashkinë Roskovec".

Bashkia Roskovec në kuadër të bashkëpunimit me Bankers Petroleum Albania, dhe të memorandimit të mirëkuptimit të nënshkruar në ndihmë të bujqësisë, si dhe duke u nisur nga kërkesat e shumta të fermerëve për mbështetjen e tyre , kërkon të ketë nje dokument bazë që të shërbejë në politikat që mund të ndërmarrim në territorin e bashkisë për zhvillimin e bujqësisë.

Ky dokument do të shërbejë për të pasur **Strategjinë për zhvillimin ekonomiko-bujqësor të Bashkisë Roskovec**, konkretisht për:

- Studimin real të kapaciteteve dhe burimeve natyrore , njerëzore, financiare dhe të cdo drejtimi tjetër që ka lidhje me bujqësinë në territorin e Bashkisë Roskovec (njësinë Kuman, Kurjan, Strum dhe Roskovec),
- Vlerësimin e këtyre mundësive për një zhvillim të integruar të bujqësisë duke parë në këtë këndvështrim :
orientimin e fermerëve në prodhimet bujqësore blegtorale etj ;
gjetjen e tregjeve të shitjes ;
mundësitë e magazinimit dhe gjithcka tjetër lidhet me këtë
- Rekomandimet konkrete për vendimarrje me të gjitha grupet e interesuara në përshpejtimin e zhvillimit të bujqësisë në këtë territor

Qëllimi: Ky studim do ti shërbejë Bashkisë së Roskovecit si një instrument planifikimi për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me fokus kryesor sektorin e bujqësisë. Shtysa kryesore për kryerjen e studimit është rëndësia që bujqësia ka si burim të ardhurash për pjesën më të madhe të popullsisë së Bashkisë së Roskovecit e cila klasifikohet si bashki rurale.



Studimi do të jetë i strukturuar si më poshtë:

Kapitulli 1 paraqet një panoramë të përgjithshme mbi Bashkinë e Roskovecit, duke ofruar informacione të përmbledhura mbi karakteristikat gjeografike, ndarjen administrative, punësimin, infrastrukturën, arsimin dhe shëndetsinë.

Kapitulli 2 i dedikohet bujqësisë në territorin e Bashkisë duke ofruar një analizë të gjendjes aktuale dhe duke përshkruar potencialet e rajonit për zhvillim të mëtejshëm të bujqësisë;

Kapitulli 3 ofron një analizë mbi tregjet bujqësore vendase dhe të huaja. Qëllimi është të pasqyrohen kanalet aktuale të shpërndarjes së produkteve bujqësore në tregun vendas dhe atë të eksportit dhe të analizohen veprime të mundshme për të rritur akesin në tregje të fermerëve dhe agrobineseve.

Kapitulli 4 prezanton historikun e operatorëve bujqësor të bashkisë në lidhje me nivelin e përfitimeve nga skemat e AZHBR, dhe ofron një përmbledhje të pengesave kryesore për të rritur mundësitë e përfitimit nga keto fonde.

Kapitulli 5 fokusohet tërësisht në analizimin e problematikave që pengojnë shfrytëzimin maksimal të potencialeve që ka bashkia duke rezultuar në zhvillim të ngadaltë të sektorit bujqësor.

Kapitulli 6 prezanton skemat e granteve të AZHBR dhe IPARD II, masat e mbështetjes dhe objektivat e këtyre programeve, si edhe analizon zgjidhje të mundshme për të rritur nivelin e përthithjes së fondeve nga operuesit bujqësor të bashkisë.

Kapitulli 7 ofron një përmbledhje të problematikave dhe mundësive për zhvillim, të prezantuar nëpërmjet një analizë SWOT për sektorin bujqësor të bashkisë.

Kapitulli 8 prezanton një list rekomandimesh të cilat bashkia duhet të marrë në konsideratë për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë;

Kapitulli 9 prezanton objektivat e Bashkisë dhe treguesit për tu monitoruar deri në vitin 2020. Objektivat lidhen me rritjen e rendimeteve, cilësisë, përmirësimin e ujitjes dhe kullimit etj.

Gjithashtu, duke qënë se nuk është parashikuar në këtë studim, Këshilli Bashkiak do diskutojë dhe rekomandojë politikat që duhet të ndjekim në lidhje me tokat bujqësore të lira që ndodhen në territorin e bashkisë tonë.

K R Y E T A R

